



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Trajnues:

Besim Kelmendi, Agim Maliqi, Behar Xhema

Prishtinë, 4- 5 Maj, 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes.....	3
Hyrje.....	4
Objektivat trajnuese.....	4
Metodologjia trajnuese.....	4
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	4
Hetimet financiare dhe sigurimi i provave në rastet e pastrimit të parave.....	5
Përgatitja dhe prezantimi në gjykatë i rastit penal për pastrim të parave.....	9
Rikthimi i pasurive të fshehura.....	12
Kërkesë për masën e përkohshme, për sigurinë e pasurisë së sekuestruar.....	12
KËRKESË PËR SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM.....	15
KËRKESË PËR URDHËR NDALUES.....	18
Rasti praktik 1.....	20
Rasti praktik 2.....	21
Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave.....	23
Legjislacioni.....	23
Llojet e Bashkëpunimit Ndërkombëtar.....	24
Bashkëpunimi mes Njësiteve të Inteligjencës Financiare.....	25
Ekipet e Përbashkëta Hetimore.....	25
Standardet ndërkombëtare të FATF – Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	26
Karakteristikat e një sistemi efektiv.....	26
Gamë e gjerë e bashkëpunimit ndërkombëtar.....	27
Shkëmbimi i shpejtë dhe konstruktiv i informacionit.....	27
Memorandumet e Bashkëpunimit.....	27
Shkëmbimi i informacionit spontan/sipas kërkesës.....	28
Kryerja e analizave në emër të homologëve të huaj.....	28
Siguria e Informacionit.....	29
Kushtet jo-proporcionale dhe padrejtësisht të kufizueshme.....	29
Refuzimi në bazë të ligjeve të konfidencialitetit.....	29
Përdorimi i informacionit të shkëmbyer.....	29
Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit.....	30
STKE 198 - Konventa e Këshillit të Evropës.....	30
Bashkëpunimi Rajonal.....	31
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR - Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara.....	32
Përforcimi i përdorimit të inteligjencës financiare si dhe i të dhënave të tjera të ngjashme.....	33
Hetimi dhe ndjekja penale.....	35
Pastrimi i parave si vepër penale autonome dhe përdorimi i provave rrethore.....	36
Burimet dhe literatura.....	38

Hyrje

Nëse bëjmë një përmbledhje të efekteve të Pastrimit të Parave, është e qartë se fenomeni dëmton institucionet financiare, çekuilibron konkurrencën e ndershme në treg, ndikon në mënyrë negative në nivelin e investimeve dhe produktivitetin, lehtëson korrupsionin dhe krimin në kurriz të zhvillimit ekonomik si dhe ndikon në uljen besimit të publikut për zbatimin e ligjit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar ofron informacionin, informacionin e fshehtë dhe provat financiare të duhura dhe lehtëson veprimin kundër kriminelëve dhe pasurive të tyre.
Objektivat trajnuese

Ky trajnim do t'ju ndihmojë të zgjeroni njohuritë tuaja në lidhje me:

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

Zbatojnë drejtë, dispozitat ligjore lidhur me kualifikimin juridik të pastrimit të parave;
kryejnë hetime pro aktive penale dhe financiare dhe të sigurojnë prova të pranueshme që mbështesin aktakuzat e ngritura;

shqiptojnë sanksione adekuate penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale;

sekuestrojnë dhe konfiskojnë pasurinë e fituar më këto vepra penale;

krahasojnë legjislacionin vendor me atë të BE-së;

zbatojnë format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë.

Autoriteti i NJIF-it në bashkëpunimin ndërkombëtar

Rekomandimet e FATF & Ligji për LPP/LFT (AML/CFT)

Direktiva e BE & Konventa e Këshillit

Parimet e Egmont Group

PSO për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit

Shembuj të rasteve

Metodologjia trajnuese

Për realizimin e trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara trajnuese shpjegime teorike, diskutimet interaktive, studimi i rasteve praktike. Për më tepër, pas vendimeve të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, është përdorë metoda online përmes platformës së mësimin në distance E-learning dhe përmes platformës elektronike Zoom.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit do të përfitojnë nga njohuritë e fituara lidhur me bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave, legjislacionin e aplikuar në vend dhe standardet ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT). Ndarja e inteligjencës financiare midis shteteve është e një rëndësie të madhe dhe është bërë themeli i përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar PP / FT. Autoritetet kompetente kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar për ndjekjen e kriminelëve dhe pasurive të tyre. Pjesëmarrësit pritet të përfitojnë nga zgjerimin e njohurisë së tyre për ndërmarrjen dhe sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e shpëlarjes së parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të shpëlarjes së parave dhe aktivitetit terrorist.

Pjesmarrësit do të rrisin njohurit e tyre lidhur me përdorimin e inteligjencës financiare si dhe i të dhënave të tjera të ngjashme (RTD e marra dhe të kërkuara nga autoritetet kompetente, shpërndarja e rasteve dhe bashkëpunimi si dhe shkëmbimi i të dhënave të inteligjencës financiare).
Hetimet financiare dhe sigurimi i provave në rastet e pastrimit të parave

Në hetimet financiare secili prokuror apo hetues duhet ti parashtoj vetës tre pyetje:

1. A janë shumtë burimeve të njohura apo të dokumentuara (ligjore) të barabarta me shpenzimet dhe asetet e blera nga i dyshuari?
2. Nëse jo, cili është burimi i fondeve të të dyshuarit të përfshira në transaksione?
3. Si i ka kontrolluar i dyshuari fondet e pronës së njohur e cila ka qenë nën kontrollin të tij?

Për të treguar fitimet e paligjshme duhet të vendoset nëse do të përdorim një metodë të drejtpërdrejtë, metodë të veçantë, ose një metodë indirekte të provave.

Metodat e provës indirekte përfshijnë depozitat bankare, me vlerë neto ose të shpenzimeve.

Një tjetër metodë e provave është **metoda e ekstrapolimit**. Shembull është një rast i vërtetë - një bordello përdor çarshafë të freskët për çdo klient. Çmimi i bordellos bazë për shërbimet është x euro, hetuesi shkoi në lavanderi dhe dokumenton numrin total të çarshafëve të pastruar në (L). Llogaritje për të ardhurat për bordello ishin numri i çarshafëve here çmimi për një klient.

Metodat indirekte përdoren mirë, kur një i dyshuar është duke marrë valutë ose ka pagesa të shumta që nuk mund të gjurmohen. Shumica e kryerësve të veprave penale nuk mbajnë libra dhe regjistrime të fitimit të tyre të paligjshëm.

Parimi themelor pas përdorjes së metodës indirekte të provës është që kur merren paratë fitimi mund të llogaritet ose nga një rritje në të holla në dorë, një rritje në llogaritë bankare, një rënie në borxhe, pagim i shpenzimeve të jetesës, ose një rritje në asete .

Zakonisht jetesa e të dyshuarit ose e aseteve pasqyrojnë pasurinë përtej burimeve të ligjshme.

Pasuria që nuk mund të shpjegohet me burimet e ligjshme është **dëshmi e fuqishme për të provuar veprimtari të paligjshme**. Disa skema kriminale mund të jenë shumë të komplikuar dhe mund të shpiken alibi, por dëshmia e pasurisë përtej mundësive të ligjshme shpesh mund të ndikoj në gjetjen e faktit.

Paraja eventualisht vihet në pah direkt apo indirekt, në llogari, asete ose shpenzime të kryerësve të veprave penale

Fillimisht shtrohet pyetja së çfarë do të bëjë kryesi i veprës penale me para?

Ti ruaj në një bankë

Ti shpenzojë në jetesë

Ti shpenzojë ato në asete

Ti investojë në Aksione, Pronë etj

Shembull: Një zyrtar i qeverisë ilegalisht pranon një pagesë nga një kompani ndërtimi. Hetuesi merr një kopje të çekut të zyrtarit të qeverisë, një kopje të deklaratës së bankës duke treguar një depozitë

në llogarinë e tij dhe një kopje të pagesës së kompanisë ndërtimore që tregon pagesën e regjistruar si shpenzim "promovimi". Këto objekte janë të gjitha dëshmi të drejtpërdrejta të pagesës.

Për një hetim të mirë financiar, gjithnjë është e nevojshme që të identifikohen burimet e informatës financiare dhe asetëve të kryerësve të veprave penale

Burimet e informatës financiare

Bankat
Regjistrat Publik
Databazat për Zbatim të Ligjit
Databazat Komerciale
Mbikqyrja
Informatorët
Intervistat
Autorizim për kërkim
Monitorimi Elektronik
Sekrete
Mbeturina
Pagesat e telefonit

Identifikimi i asetëve

Para
Patundshmëri
Investim biznesor
Balance të llogarisë bankare
Të mbledhura
Entitete ligjore
Automjete
Pajisje shtëpiake
Xhevahirë
Veshëmbathje dhe prona tjera personale
Anije dhe aeroplan, etj.

Gjurmo dhe dokumento pranimin e fondeve nga i dyshuari, Zakonisht nga pika e pagesës

<u>Pagesa</u>	<u>Shuma</u>
ABC Kompaniaj	12,345
Ace LLC	56,789
Bee Corp	98,760
Zee Ltd	54,321
TOTALI	222,215
Faturat në libër	156,785
Shuma e paregjistruar	64,430

Të hetimet financiare duhet të analizojmë të gjitha llogaritë bankare të një personi, ato të biznesit dhe ato personale, duke përfshirë llogaritë e bashkëshortes dhe fëmijëve të subjektit, si dhe faktet së:

Kur është blerë aseti?

Nga kush është blerë?

Sa ka KUSHTUAR?

Si është paguar (para apo kredi)?

Cilat burime të fondeve janë përdor për ta blerë?

Çfarë dokumente ekzistojnë për blerjen, dhe ku është e lokalizuar?

Përveç asaj që u tha më sipër duhet identifikuar edhe detyrimet apo borxhet. Një detyrim (borxh) mund të vjen edhe nga një premtim gojor apo i shkruar për të paguar dhe në këto raste duhet të përcaktohet:

Cila është shuma origjinale e borxhit?

Kur është data për balansin aktual?

Kur është bërë detyrimi?

Cili është qëllimi për huanë apo borxhin?

Si janë përdor këto aktivitete ose ku janë depozituar?

Çfarë sigurimi, nëse ka pas, është dhënë për borxhin?

Çfarë dokumentacioni ekziston për transkacionin dhe ku është?

Kush ka qenë huadhënësi apo huamarrësi?

Shumë herë një subjekt do të pretendoj se fondet që ju kanë treguar si të ardhurat e kriminit janë nga kreditë. Kjo mbrojtje duhet të tejkalohej përmes dëshmisë së kredive.

Dëshmia mbi kreditë e supozuara duhet të merret nga subjekti dhe personi që ka dhënë kredi.

Lidhur më shpenzimet e pretenduara nga kryesi I veprës penale duhet analizuar së:

Cila ka qenë shuma e shpenzimit?

Për çka është shpenzuar?

Për kënd është shpenzuar?

Ku janë marr fondet për të paguar shpenzimin?

Cili dokumentacion (siç janë dëftesat dhe faturat) ekziston dhe ku?

Pra gjatë gjithë kohës së analizës së shpenzimeve duhet patur kujdesë edhe për faktin së cilat kanë qenë të hyrat dhe shpenzimet, siç janë:

Rrogat dhe pagesat

Të hyrat me qira

Interesi/dividentët

Profiti Biznesor

Pensionit/Të ardhurat vjetore

Fondet nga burimet e tjera të njohura

Zvogëlim në paranë në dorë

Zvogëlim në bilancin bankar

Shitja e asetit

Huatë, dhurata dhe trashigimitë, çmimet e fituara

Fitimet në bixhoz

Blerja e aseteve
Shpenzimet personale të jetesës
qiraja, hipoteka, shërbimet, ushqimi, veshëmbathja
Sigurimi
Kartelat e Kreditit
Investimet
Dhuratat për tjerët
Udhëtimi
Rritja në llogaritë bankare
Rritja në paranë në dorë
Zvogëlimi në balansin e huasë

I dyshuari mund të pretendoj se ai / ajo nuk është pronari i vërtetë i një aseti. Hetuesi duhet të përcaktojë kush e ka negociuar blerjen dhe shitjen e aseteve dhe kush e kontrollon pasurinë. Hetuesi duhet gjithashtu të përcaktojë se nga kanë ardhur paratë për të blerë asete dhe te kush kanë shkuar të ardhurat nga shitjet.

Lidhur më atë që u theksua më sipër gjatë intervistimit të subjektit dhe të afërmit të tij / saj të ngushtë ata duhet të pyeten se sa të holla në dorë ata kishin në datën e caktuar dhe nga kanë ardhur. Të hetohet historia e kredisë së të dyshuarit për të përcaktuar nëse ata kanë paraqitur kërkesë për falimentim ose janë vazhdimisht me vonesë kur paguajnë faturat. Në qoftë se historia e subjektit tregon se ai nuk mund të paguajë faturat e përditshme, kjo provë do të tregojë se ai nuk kishte një të hollave të grumbulluara.

I dyshuari mund të pretendoj se ajo pasuri e pashpjegueshme rezultoi nga kredia apo kesh dhurata nga anëtarët e familjes ose miqtë e afërt ose nga një trashëgimi. Në këto raste janë të pa shmangëshme pyetjet për dëshmi të pagesave. Gjithashtu në këto raste duhet të hetohen miqtë apo të afërmit për të përcaktuar nëse ata kishin burime të paguajnë shumën që ata pretendojnë se i kanë paguar.

Themeli i një hetimi me metodë indirekte është **një pikë stabile e fillimit**. Hetuesi duhet të zgjedhë një pikë fillestare që në kohën para viteve që janë nën hetim. Përcaktimi i të gjitha aseteve dhe detyrimeve të njohura që i përkasin subjektit. Kjo do të mundësojë që të përcaktojë nëse subjekti ka shitur të gjitha pasuritë ose ka rritur apo ulur çdo detyrim gjatë viteve nën hetim. Në qoftë se po, duhet gjetur arsye për këto ndryshime në llogaritjen e tij.

Sipas rregullit themeltar mos e injoroni një mbrojtje ku i dyshuari ka grumbulluar një shumë të hollave, vetëm për shkak se kjo tingëllon e papranueshme. Në këto raste duhet në mënyrë aktive të hetohet çdo mënyrë e fitimit të këtyre të hollave

Nga një herë mund të vije deri të dështimi për të llogaritur të ardhurat e jotatueshme ose ligjore (kredi, dhurata, trashëgimi, të ardhura nga shitja e aseteve): Në llogaritje duhet të zbritet totali i të gjitha burimeve të njohura nga të ardhurat nga shpenzimet totale. Dështimi për të përcaktuar shumën e të gjitha burimeve të njohura do të shkaktojë një gabim të turpshëm në procedurë penale

Pa marrë parasysh *sa e pa bazuar një mbrojtje mund të tingëllojë, duhet të bëhet çmos për të hetuar të gjitha mbrojtjet* e ngritura nga një subjekt, e kundërta dobëson besueshmërinë tonë. Nuk është e mjaftueshme për të kryer një hetim të vetëm dhe të bëjmë një llogaritje të "fondeve nga burime të panjohura". "Burime të panjohura", mund të jenë krejtësisht të ligjshme.

Një shembull:

<u>Burimet e fondeve</u>	<u>Shpenzimet</u>	
CIA Rroga 340,000	Blerja e shtëpisë	540,000
Përmirësimet në shpi 99,000		
Mobilet	7,000	
1992 Jaguar	25,000	
1989 Honda	19,500	
Faturat e telefonit	29,800	
Kartelat e Kreditit	455,000	
Tarifat - Georgetown Univ.	25,000	
Aksione dhe Fletat me Vlerë	165,000	

Burimet Totale	340,000
Shpenzimet totale	1,365,300
Minus: Burimet e njohura	<u>(340,000)</u>

Fonde nga burime te panjohura 1,025,300

Përgatitja dhe prezantimi në gjykatë i rastit penal për pastrim të parave

Që nga fillimi i ndërmarrjes së veprimit të parë në një rast penal e deri në plotfuqishmërinë e vendimit, është detyrë e prokurorit që të kujdesët për vendosjen dhe ruajtje e secilës shkresë që është nxjerr ose është siguruar gjatë procedurës, qoftë gjatë procedurës parapenale, procedurës paraprake, gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, gjatë fazës së ankesës, gjatë shqyrtimit në shkallë të dytë apo të tretë si dhe në rastet kur paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Në asnjë rast nuk duhet pranuar shkresa nga kush do qoftë pa u bërë evidentimi i tyre dhe nënshkrimi për pranimin apo dorëzimin e tyre.

Çdo shkresë duhet vendosur në dosjen e atij rasti penal më një kujdes, duke u dhënë rëndësi datave të pranimit dhe llojit të shkresave. Kjo do të varet nga mënyra e punës e secilit prokuror, së si do të rregulloj dosjen penale që ka në punë, mirëpo për të patur një lehtësi të shfletimit dhe analizimit të secilës shkresë, që mund të jetë provë në një çështje penale, është e rëndësishme që të bëhet një ndarje apo vendosje e shkresave sipas natyrës së tyre.

Do të jetë e rëndësishme së për cilën vepër penale është duke u zhvilluar procedura penale dhe varësisht nga kjo duhet rregulluar edhe dosjen penale, duke vendosur shkresat që kanë të bëjnë më fillimin e hetimeve, autorizimet, kërkesat, urdhëresat, aktvendimet e ndryshme, fletëkthesat, në një ndarje të veçantë dhe pastaj në ndarjen tjetër të vendosen raportet e policisë për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit nëse ka patur masa të tilla, transkriptet e bisedave telefonike, listat e thirrjeve telefonike, videoincizimet dhe foto e ndryshme. Një ndarje e veçantë do të ishte edhe vendosja e deklaratave të pandehurve dhe e dëshmitarëve e nëse janë më shumë të pandehur dhe dëshmitar, deklaratat e tyre mund të vendosen në ndarje të veçanta.

Gjithashtu ndarje e veçantë e vendosjes së shkresave mund të jetë edhe ndarja që ka të bëjë më të dhënat financiare, duke përfshirë raportet e policisë, raportet e analistëve apo ekspertëve.

Nëse rasti penal nuk ka shumë të pandehur dhe dëshmitar ose shumë shkresa atëherë është e mjaftueshme që brenda një dosje, shkresat të vendosen më ndarëse, qoftë më numra qoftë më shkronja. Kjo ndihmon prokurorin që të gjendet shumë më lehtë kur e prezanton rastin në gjykatë, duke marrë parasysh renditjen e prezantimit të provave në shqyrtimin gjyqësor.

Në rastet kur ka shumë shkresa, duhet patur kujdes që këto shkresa të vendosen në ndarje të veçantë dhe atë sipas etapave që nga fillimi i veprimeve inkriminuese e deri te arrestimi i personave të dyshuar, në mënyrë që kur të administrohen si prova në shqyrtimin gjyqësor prokurori të ketë më të lehtë të provojë shkeljet nga ana e të pandehurve sipas fazave të veprimit.

Në të gjitha rastet penale pavarësisht së a ka shumë shkresa apo pak, gjithsesi duhet të përpilohet indeksi ose lista e shkresave e cila shërben për të gjetur më lehtë secilën shkresë që i nevojitet prokurorit, qoftë gjatë përgatitjes së aktakuzës, qoftë kur përfaqëson aktakuzën dhe provat në shqyrtimin gjyqësor. Më së miri është që indeksi përveç që printohet në letër edhe të ruhet në mënyrë elektronike në kompjuterin e prokurorit dhe asistentes së tij, sepse kështu mund të plotësohet apo ndryshohet më lehtë.

Në rastet kur ka dëshmitar të mbrojtur ose dëshmitar bashkëpunues të cilët kanë shprehur dëshirën që të jenë edhe të mbrojtur, duhet patur kujdes që deklaratat e tyre si dhe çdo shkresë tjetër që mund të zbulojë identitetin e tyre të vendoset në ndarëse të veçantë dhe sipas nevojës të vendosen në pliko deri sa nuk kërkohet që të prezantohet para gjykatës në shqyrtimin gjyqësor.

Një rëndësi të veçantë gjatë tërë procedurës dhe në veçanti kur bëhet dorëzimi i shkresave të lëndës për të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre duhet ti kushtohet rasteve kur janë urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, sepse praktika ka treguar së ka mjaft raste që keqpërdoren transkriptet e bisedave telefonike apo komunikimet përmes SMS-ave në mes të akuzuarve dhe personave tjerë që mund të jenë të pa fajshëm dhe rastësisht të përfshirë në biseda apo komunikimet telefonike më të akuzuarit. Gjithnjë është e domosdoshme që të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre tu dorëzohen vetëm ato transkripte dhe telekomunikime që kanë lidhje me çështjen penale e assesi të gjitha komunikimet në mes të akuzuarve dhe personave tjerë që janë siguruar gjatë zbatimit të masave të fshehta.

Në rastet e aplikimit të masave të fshehta duhet patur parasysh edhe detyrimin e njoftimit të personave që kanë qenë nën masat e fshehta ose që janë prekur më masat e fshehta, siç është parashikuar më dispozitën e nenit 96 të Kodit të Procedurës penale dhe siç është dhënë udhëzimi i Kryeprokurorit të shtetit në muajin nëntor 2015.

Edhe gjatë përpilimit të aktakuzës prokurori duhet ti kushtojë kujdes jo vetëm dispozitivit të aktakuzës, ku duhet të përfshihen shumë qartë elementet e veprës penale, siç janë: koha, vendi, mënyra dhe kualifikimi juridik por edhe arsyetimit, sepse një arsyetim i mirë i hartuar sipas kronologjisë dhe zhvillimit të ngjarjes do ti ndihmojë tej mase prokurorit që të prezantojë atë më lehtë dhe më mirë para gjykatës.

Zakonisht një arsyetim i aktakuzës fillon më paragrafin që tregon së janë zhvilluar hetimet dhe së gjatë hetimeve janë mbledhur provat duke i përmendur të gjitha ato një nga një. Pastaj duke vazhduar më paragrafin pasues ku përshkruhet deklaratat e të dëmtuarit, pastaj përmbajtjet e deklaratave të pandehurve dhe dëshmitarëve.

Pas përshkrimit të përmbajtjeve të deklaratave është e nevojshme që të përshkruhen provat tjera një nga një më radhë duke treguar se çka tregon secila prej tyre, në mënyrë që pas përshkrimit të tyre të filloj analiza e tyre dhe të nxjerrët përfundimi së cila është vepra penale që është kryer, duke arsyetuar secilin nga elementet e veprës penale.

Në fund të arsyetimit të aktakuzës është e nevojshme që prokurori të kërkoj që i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe në këtë rast nuk është e ndaluar që nëse dikush nga të pandehurit apo dëshmitarët bashkëpunues ka kontribuar më deklaratat e tyre në zbardhjen e çështjes penale ose në zbulimin e veprës penale dhe kryesit të saj të përmendet dhe kështu ti bëhet më dije gjykatës që këto rrethana ti merr parasysh gjatë shqiptimit të sanksionit penal.

Siç mund të shihet kronologjia e arsyetimit të aktakuzës deri në një masë të madhe përputhet më kronologjinë e zhvillimit të vet shqyrtimit gjyqësor, i cili fillon më leximin e aktakuzës, fjalët hyrëse të prokurorit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe nëse ai nuk e pranon fajësinë vazhdon më deklarin e dëshmitarëve (dhe eksperteve) administrimin e provave tjera dhe më pastaj më deklarin e të akuzuarit, zbulimin e të kaluarës kriminale të akuzuarit dhe marrjen e vendimit mbi fajësinë dhe sanksionin penal.

Përgatitja e fjalës hyrëse nga ana e prokurorit është një detyrë e rëndësishme për çështjen penale në tërësi dhe në veçanti për imazhin e tij si profesionist, për gjyqtarin e vetëm ose trupin gjykues dhe për publikun e pranishëm, sepse përmes fjalës hyrëse prokurori do ta ketë mundësinë që të tregoj së ai e ka zhvilluar procedurën paraprake në mënyrën më të mirë të mundur, së ai e njeh mirë rastin, së ai e njeh mirë aktakuzën e dorëzuar në gjykatë dhe kështu ti bind të pranishmit së ai do të prezantoj prova të rëndësishme dhe bindëse që e mbështesin aktakuzën e tij. Sa më mirë që të bëhet prezantimi i provave në fjalën hyrëse, aq më lehtë do të paraqiten ato prova gjatë administrimit të tyre.

Gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor kur bëhet prezantimi i provave, prokurori duhet ti jep rendësi asaj që ka thënë në fjalën hyrëse dhe mundësisht ti përmbahet kronologjisë së paraqitjes së provave në aktakuzë.

E njëjta provë mund të prezantohet në fjalën hyrëse, gjatë marrjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë në pyetje si dhe gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare.

Si shembull mund të merret një kontratë për një tender e nënshkruar në mes të akuzuarit si drejtor i prokurimit dhe përfaqësuesit të kompanisë që është punë kryese.

Kështu në fjalën hyrëse vetëm duhet, prezantuar këtë kontratë si një provë që do të tregojë së kush janë nënshkruesit e saj dhe cilat ishin afatet e zbatimit të saj.

Gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje e shfrytëzojmë këtë provë për të bërë pyetje më sfond të hapur, psh kur është nënshkruar, kush e ka nënshkruar, pse është nënshkruar, sa ka qenë vlera e kontratës, si është dashur të zbatohet kontrata, cila ka qenë periudha e zbatimit të saj, pse nuk është zbatuar kontrata brenda këtij afati etj.

Gjatë marrjes së tërthortë në pyetje kjo kontratë mund të shërbejë për të bërë pyetje si në vijim: ju e keni nënshkruar këtë kontratë, ju e keni ditur së kontrata duhet të zbatohet brenda afatit prej 6 muajve, kjo kontratë nuk është zbatuar brenda këtij afati, kompania punë kryese nuk është penalizuar për mos zbatimin e kontratës brenda af kotit kontraktues etj.

Edhe në rastin e fjalës përfundimtare, e njëjta provë mund të përdoret për të argumentuar fajësinë e

të akuzuarit duke nxjerr përfundime së është vërtetuar dhe së nuk është kontestuese së kontrata ishte nënshkruar nga i akuzuari, së afati për zbatimin e kontratës ishte 6 muaj, së kontrata nuk ishte zbatuar brenda këtij afati dhe së kompania punë kryese nuk ishte penalizuar për mos zbatimin e kontratës brenda afateve kontraktuese etj.

Gjatë prezantimit të provave në shqyrtimin gjyqësor do të ishte e dëshirueshme që prokurorët të përdorin monitorët për të prezantuar në mënyrë vizuale provat e tyre, sepse kjo rritë interesimin e trupit gjykues dhe të pranishmëve tjerë në njërenë anë dhe në anën tjetër Prokurorit do ti jepej mundësia që të tregoj edhe detaje nga pamja vizuale e provës.

Si shembull mund të ishte paraqitja në mënyrë vizuale të shtëpisë/banesës ose lokalit ku janë takuar të akuzuarit me rastin e shkëmbimit të parave dhe nëse ka pamje edhe nga brendia e shtëpisë/banesës ose lokalit atëherë do të shpjegohet më mirë së ku ishin ata të ulur kur u dhanë paratë dhe si u dhanë ato, a ishte përzgjedhur vendi për të shkëmbyer paratë. Nëse edhe dikush ka qenë prezent, ku ishin ata dhe çfarë bënin kur ishte bërë shkëmbimi i parave etj.

Sa i përket performacës së prokurorit në shqyrtimin gjyqësor duhet ti kushtohet kujdes kodit të etikës dhe kodit të veshjes. Në të dy rastet prokurori e ka për detyrë që të përformoj si profesionist duke prezantuar të gjitha provat, duke përfshirë ato që shkojnë në favor të aktakuzës dhe ato që shkojnë në favor të të akuzuarit dhe gjatë prezantimit të ketë një veshje solemne / zyrtare, sepse kjo mund të ndikoj në rritjen apo zvogëlimin e imazhit jo vetëm të atij personalisht por edhe të sistemit prokurorial në tersi.

Rikthimi i pasurive të fshehura

Kërkesë për masën e përkohshme, për sigurinë e pasurisë së sekuestruar



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore ne _____ / Osnovno Tuzilastvo u _____ / Basic Prosecution Office _____

PP__nr. _____

Në _____,

Më datë _____

GJYKATËS THEMELORE NE _____

DEPARTAMENTIT _____

P Ë R

GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE

Pas rishikimit të raporteve të Policisë së Kosovës – sektori për hetimet e integruara financiare në Prishtinë - referenca _____ i datës _____ dhe në pajtim me nenin _____ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqesë këtë:

Kërkesë për masën e përkohshme, për sigurinë e pasurisë së sekuestruar

Kundër të pandehurit: _____ (shënimet personale)

S E P S E

Ekziston dyshimi i bazuar se _____ (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dh ekryerjen e veprës penale)

Më këtë kishte për të kryer veprën penale:

- _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,

ARSYETIM:

Policia e Kosovës – Drejtoria _____ në _____ më datë _____, i ka paraqitur Kallëzim Penal në Prokurorisë Themelore në _____ - Departamentit _____, më numër të referencës _____ në _____, kundër të pandehurve _____, _____ dhe _____ për shkak të dyshimit se të njëjtit kanë kryer veprën penale _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në _____ pas marrjes së kallëzimit penal më datë _____ ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve PP____.nr._____ pasi që ka gjetur se në këtë rast bëhet fjalë për veprën penale - _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së hetimeve janë marr në pyetje edhe të pandehurit, _____, _____ dhe _____, janë zbatuar masat e fshehta teknike te vëzhgimit dhe hetimit, siç janë: _____, është bërë ekspertimi i sendeve të sekuestruara nga të pandehurit, janë siguruar edhe provat tjera me të cilat vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën e lartcekur penale që ju vihet në barrë.

Gjatë kontrollit dhe arrestimit të te pandehurve _____, _____ dhe _____, policia e Kosovës ka sekuestruar ne mes tjerash edhe Veturën e markës “_____” ngjyrë të _____ me tabela të regjistrimit _____, pronë e të pandehurit _____, veturën e markës “_____” më ngjyrë të _____ me tabela të regjistrimit _____ pronë e të pandehurit _____.

Më datën _____ duke vepruar në bazë të nenit _____ të KPPK-së Policia e Kosovës – Drejtoria _____ në _____ pas njoftimit të prokurorit dhe pasi që nga prokurori ishte njoftuar edhe gjyqtarja e procedurës paraprake, e cila ka dhënë urdhrin gojor, policia ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurve: _____ dhe _____ në _____, ku e ka gjetur _____

Gjyqtarja e procedurës paraprake, nw bazw tw kwrkesws sw Prokurorit tw Shtetit, më urdhëresën _____ të datës _____ ka lëshuar urdhrin për konfirmimin e urdhrin gojor për kontrollin e shtëpisë së të pandehurve _____ dhe _____ në _____.

Gjatë kontrollit të lartcekur policia ka sekuestruar nga i pandehuri _____ sendet si në vijim:

Fakti së shtëpia që është ne pronësi të te pandehurit _____, që gjendet ne _____ rruga “_____” nr. _____, është shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë, është vërtetuar nga raporti i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit _____ numër _____ të datës _____, si dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, nga deklarata e të pandehurit _____, i cili ka deklaruar së _____.

Më datën _____ gjyqtari i Procedurës Paraprake ka lëshuar urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të shtëpisë që është ne pronësi të te pandehurit _____, ndërsa ne bazë të raportit të policisë së Kosovës nr. _____ të datës _____, rezulton së policia ka zbatuar urdheresen e lartcekur të gjyqtarit të procedurës paraprake për sekuestrimin e përkohshëm të shtëpisë që është ne pronësi të te pandehurit _____.

Duke marr parasysh së pasuria e sekuestruar përkohësisht ka gjasa të konsiderueshme së nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose së do të përdoret në kryerjen e veprës së ngjashme penale, konsideroj se masa e përkohshme për sigurinë e pasurisë është e nevojshme sepse kjo pasuri mund të tjetërsohet apo të përdohet për të kryer vepër të ngjashme penale nëse nuk merren masa mbrojtëse

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit _____ të KPPK-së, prokurori i nënshkruar më poshtë, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se i pandehuri _____ ka kryer veprat penale të theksuara më lartë dhe duke marr parasysh se ka shfrytëzuar pasurinë e tij – shtëpinë ne _____ rruga “_____” nr. _____, dhe kjo pasuri ja ka mundësuar kryerjen e veprës penale, i propozon gjyqtarit të procedurës paraprake:

Që të nxjerr urdhër për masën e përkohshme për sigurinë e pasurisë nga neni _____ të KPPK-së për:

shtëpinë që gjendet ne _____ rruga “_____” nr. _____, që është pronësi e të pandehurit _____, si pasuri që i ka mundësuar të pandehurit kryerjen e veprës penale - _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokurori i Shtetit

N.N.

KËRKESË PËR SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore ne _____ / Osnovno Tuzilastvo u _____ / Basic Prosecution Office _____

PP ____ .nr. _____

Në _____,

Më datë _____

GJYKATËS THEMELORE NË _____
DEPARTAMENTIT _____
P Ë R
GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE

Pas rishikimit të raporteve të Policisë së Kosovës – sektori për hetimet e integruara financiare në Prishtinë - referenca _____ i datës _____ dhe në pajtim me _____ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqesë këtë:

KËRKESË PËR SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM

Të shtëpisë që është ne pronësi të pandehurit _____, e cila gjendet në _____ (shëno adresën), si pasuri që i ka mundur kryerjen e veprës penale.

Kundër të pandehurit: (shëno të dhënat personale)

S e p s e

Ekziston dyshimi i bazuar (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më ketë kishte për të kryer veprën penale:

- _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

ARSYETIM

Më shkresën e policisë së Kosovës – Departamenti _____ nr. _____ të datës _____, Prokuroria është njoftuar së i dyshuari _____ është i përfshirë në kryerjen e veprës _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh këtë shkresë të policisë, Prokuroria Themelore në _____ në këtë çështje penale urgjentisht ka lëshuar urdhrat e përkohshëm për masat e fshehta _____ më datat _____ dhe _____ për shkak së ekziston dyshimi i bazuar së i pandehuri është përfshirë në kryerjen e veprës penale të lartcekur dhe se pritja e lëshimit të urdhrat nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, për këtë masë mund të rrezikonte sigurimin e provave të rëndësishme për këtë fazë të hetimeve.

Gjyqtarja e procedurës paraprake më urdhëresën _____ nr. _____ të datës _____ ka konfirmuar urdhrat e lartcekur të Prokurorisë Themelore.

Nga raporti i policisë së Kosovës – Drejtoria _____ i datës _____ lidhur më zbatimin e urdhrave të lartcekur rezulton si në vijim: _____ (shëno të gjeturat nga raportet e policisë)

Pas pranimit të raportit të policisë prokurori i shtetit ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit _____ për shkak të dyshimit së kanë kryer veprën penale: _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën _____ duke vepruar në bazë të nenit _____ të KPPK-së policia e Kosovës – Drejtoria _____ në _____ pas njoftimit të prokurorit të shtetit dhe pas marrjes urdhrat gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit _____ në _____ (shëno adresën), ku ka sekuestruar _____ (shëno saktë së qka është sekuestruar nga policia gjatë kontrollit)

Gjyqtarja e procedurës paraprake me urdhëresën _____ nr. _____ të datës _____ ka konfirmuar aprovimin retroaktiv të kontrollit të lartcekur të kryer nga Policia e Kosovës.

Fakti së shtëpia është në pronësi të të pandehurit _____, që gjendet në _____ (shëno adresën) është shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë, pra për të ja mundësuar kryerjen e veprës penale ka rezultuar nga: _____.

BAZAT LIGJORE:

Neni _____ paragrafët _____ dhe _____ të KPPK

Paragrafi _____. **Sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë** sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, **sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale**, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të

cilat ligji parasheh sekuestrimin.

Paragrafi _____. Prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave apo parave. Kërkesa e tillë duhet të cek me saktësi sendet, pasurinë, provat apo paratë dhe duhet të përshkruajë si mund të jenë këto sende prova të veprës penale, si këto sende, pasuri apo para mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale. Sendet, pasuria, provat apo paratë mund të sekuestrohen përkohësisht vetëm me urdhër të gjykatës.

Paragrafi _____. Ndërtesat apo prona e paluajtshme që sekuestrohet përkohësisht vendosen njoftimet e vëna në atë ndërtesë apo pronë të paluajtshme që njoftojnë qytetarët se prona i është nënshtruar sekuestrimit të përkohshëm, që hyrja në të nuk është e lejuar dhe që ata që hyjnë pa leje mund t'i nënshtrohen arrestit.

Nga sa u tha më sipër, prokurori i nënshkruar më poshtë, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri _____ ka kryer veprat penale të theksuara më lartë dhe duke marr parasysh se ka shfrytëzuar pasurinë e tij - _____ (shëno adresën), ja ka mundësuar kryerjen e veprës penale në atë mënyrë që: _____, i propozon gjyqtarit të procedurës paraprake

Sekuestrimin e Përkohshëm të:

_____ që është pronësi të pandehurit _____, e cila gjendet në _____ (shëno adresën), si pasuri që i ka mundësuar të pandehurit _____ kryerjen e veprës penale - _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur më veprën penale - _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Prokurori i Shtetit

N.N.

KËRKESË PËR URDHËR NDALUES



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore ne _____ / Osnovno Tuzilastvo u _____ / Basic Prosecution Office _____

PP .nr. _____

Në _____,

Më datë _____

GJYKATËS THEMELORE NË _____

DEPARTAMENTI _____

PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të raportit të Policisë së Kosovës – Drejtoria _____ në _____ Referenca _____ dhe materialeve të tjera që përmban kjo çështje penale dhe në pajtim me nenin _____ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) , paraqes këtë:

KËRKESË PËR URDHËR NDALUES

Kundër të pandehurit: _____, _____ dhe _____
(shëno të dhënat personale të të pandehurit, duke përfshirë edhe numrat e xhirollogarive bankare nëse është e mundur), Institucionet financiare: _____ detyrohen që menjëherë të ndalojnë çfarëdo aktiviteti të mëtejme të llogarisë bankare të përshkruar në këtë urdhër.

S E P S E

Ekziston dyshimi i bazuar (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më këtë kishin për të kryer veprën penale:

- _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Më shkresën e policisë së Kosovës – Drejtoria _____ nr. _____ të datës _____, Prokuroria është njoftuar së i pandehuri _____ është e përfshirë si pjesë e grupit kriminal

të organizuar në kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh këtë raport të policisë dhe faktin se kjo çështje penale kërkonte veprim më urgjencë, në mënyrë që të sigurohen provat e nevojshme dhe për të ju shmangur mundësisë së zhdukjes së këtyre provave, Prokuroria Themelore e _____ në këtë çështje penale urgjentisht ka lëshuar urdhrat e përkohshëm për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit _____ më datat _____ dhe _____, për shkak të ekzistencës së dyshimit të bazuar në pandehuri _____ së bashku me të pandehurit _____ dhe _____ janë të përfshirë në kryerjen e veprave penale të lartcekura dhe se pritja e lëshimit të urdhrat nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, për këtë masë mund të rrezikonte sigurimin e provave të rëndësishme për këtë fazë të hetimeve.

Gjyqtarja e procedurës paraprake më urdhëresën _____nr. _____ të datës _____ ka konfirmuar urdhrat e lartcekur të Prokurorisë Themelore.

Nga raporti i policisë së Kosovës – Drejtoria _____ Nr. _____ i datës _____ lidhur me zbatimin e urdhrave të lartcekur rezulton si në vijim: _____ (shëno të gjeturat nga raportet e policisë)

Më datën _____ gjyqtarja e procedurës paraprake me urdhëresën _____nr. _____ të datës _____ ka lëshuar urdhër për kontrollin e shtëpisë dhe lokaleve tjera të të pandehurit _____ i cili urdhër është zbatuar nga Policia e Kosovës më datë _____.

Më datën _____ prokurori i shtetit ka nxjerr urdhër të përkohshëm ndalues për ngrirjen e aseteve kundër të pandehurve _____ dhe _____.

Nga sa u tha më lartë rezulton se në veprimet e të pandehurve: _____, _____ dhe _____, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të kësaj kërkese dhe se është e nevojshme që të zhvillohen hetimet, në mënyrë që të grumbullohen provat e nevojshme, duke përfshirë edhe të dhënat financiare të të pandehurit për të verifikuar qarkullimin e mjeteve financiare neper institucionet financiare, në mënyrë që të verifikohen përfitimet financiare, andaj është e nevojshme që të lëshohet edhe urdhri ndalues i cili duhet të ketë efektin për çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin i/e cili/a menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejme të llogarisë bankare të përkohshëm në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin ndalues. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin ndalues duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrat.

Duke marr parasysh se ekziston dyshimi i bazuar në të pandehurit _____, _____ dhe _____, kanë kryer veprat penale siç parashihet në nenin _____ të KPPK-së dhe faktin se të pandehurit mund të nxjerrin nga xhirollogaritë e tyre në Institucionet financiare dhe shfrytëzojnë asetet – parat që dyshohet se janë fituar më kryerjen e veprave penale të lartcekura, kërkoj nga ju që të nxirni urdhër ndalues:

1 Kundër të pandehurve _____, _____ dhe _____, duke përfshirë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejme të llogarisë bankare të të pandehurve në

institucionet financiare si në vijim:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Bankën Ekonomike

Prokurori i shtetit

N.N.

Rasti praktik 1

A.A. është një shtetas i Kosovës që në vitin 1990 ka migruar në Gjermani dhe atje ka hapur një restorant ku ka të punësuar 20 punëtor dhe një fitim mujor prej 20,000.00 euro.

Deri në vitin 2000 A.A. paguante më rregull të gjitha kontributet tatimore dhe pensionale për vete dhe të punësuarit në restorant si dhe tatimin në fitim, mirëpo për shkak të një problem familjar A.A. në vitin 2000 u dashtë që të shpenzoj shumë para për të rregulluar problemin familjar dhe filloj të mos paguaj më rregull kontributet pensionale dhe tatimore si dhe tatimin në fitimin e shtuar.

Duke qenë i vetëdijshëm së autoritetet gjermane mund ta ndjekin penalisht për mos pagimin e kontributeve pensionale dhe tatimore për të punësuarit në restorant dhe tatimin në fitimin e shtuar A.A. filloj që një pjesë të fitimit ta orientoj në blerjen e makinave të përdorura dhe dërgimin e tyre në Kosovë për ti shitur dhe nga fitimi në Kosovë ndërtoj dy shtëpi dhe bleu dy lokale në qendër të qytetit të Pejës të cilat së bashku vlerësohen së kanë një vlerë prej 1.000.000,00 euro.

Në vitin 2009 Policia financiare në Gjermani filloj hetimin kundër A.A. për shkak të dyshimit së I njëjti I kishte ikur pagesës së kontributeve pensionale dhe tatimore si dhe tatimit në fitimin e shtuar. Në muajin janar të vitit 2010 Prokuroria e qytetit në Essen të Gjermanisë ngriti aktakuzë kundër A.A. për shkak të veprës penale shmangie nga tatimi dhe evazion fiskal për të cilat ishte parashikuar dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 3 viteve, për secilën veç e veç, mirëpo A.A. kishte ikur nga Gjermania dhe kishte ardhur në Kosovë, ku kishte vazhduar biznesin e tij të njëjtë, në dy lokalet që i kishte blerë në Pejë, ndërsa Gjykata në Gjermani nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për shkak së kishte njohuri së A.A. ishte larguar nga Gjermania dhe kishte shkuar në Kosovë.

Në muajin Korrik 2016 autoritetet gjermane i paraqiten autoriteteve të Kosovës kërkesën që kundër të akuzuarit A.A. të filloj procedura e ekstradimit, pasi që i njëjti në vitin 2001 kishte fituar shtetësinë gjermane ose që kundër të njëjtit të filloj procedura penale në Kosovë për shkak së ai kishte edhe shtetësinë e Kosovës.

Tani autoritetet e Kosovës janë duke shqyrtuar kërkesën e autoriteteve të Gjermanisë dhe janë duke menduar që pranojnë rastin nga autoritetet gjermane për veprat penale për të cilat ishte akuzuar A.A. në Gjermani dhe të fillojnë procedurën penale kundër tij edhe për shkak të veprës penale - pastrimi i parave, sipas Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 18 / më datë 15 qershor 2016.

Afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, sipas Kodit Penal të Gjermanisë, janë të njëjta më afatet e parashkrimit të ndjekjes penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj lidhur më këtë rast mund të paraqitet problemi i parashkrimit të ndjekjes penale të A.A. për veprat penale për të cilat ishte ngritur aktakuza në Gjermani në vitin 2010.

Pyetje për diskutim:

Si duhet të veprojnë autoritetet e Kosovës lidhur më kërkesën e autoriteteve të Gjermanisë?

A ka pastrim të parave në këtë rast?

Si do të vepronit ju nëse ka arritur afati i parashkrimit për veprat penale për të cilat ishte akuzuar A.A. në Gjermani në vitin 2010?

Rasti praktik 2

Personi J.L është pronari i kompanisë "M", kurse I.L është pronar i kompanisë N.T.P "R", kompanitë e tyre janë të regjistruara si biznese të tregtisë së brendshme dhe të dhe jashtme dhe veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në territorin e Kosovës.

Kompanitë kanë blerë mallra nga Republika e Kinës dhe atë këpucë të llojeve të ndryshme, kurse pagesat i kanë bërë duke deponuar para në llogaritë përkatëse në bankat e Kosovës e pastaj nga këto llogari bankare transferojnë në bankat e Republikës së Kinës dhe atë: kompania "M" ka transferuar mjete jashtë vendit në shumen prej 819.344.57 €, kurse nga deklaratat doganore del se ka importuar mallra me vlerë prej 1.006.135.95 €, kurse kompania N.T.P "R", ka transferuar mjete jashtë vendit në shumen prej 645.655.73€, kurse nga deklaratat doganore del se ka importuar mallra me vlerë prej 733.226.71 €.

J.L pranon faktin se ka qenë pronar i kompanisë "M", kurse gjatë veprimtarisë së tij tregtare vazhdimisht ka blerë këpucë të llojeve të ndryshme dhe atë nga një person nga Bullgaria, të cilin e ka partner të biznesit dhe njëkohësisht me të ka pasur raporte miqësore. Përndryshe me pagesat dhe procesin e importit është marrë kontabilisti dhe i njëjti nuk ka pasur njohur për procedurat doganore, por se e ka të ditur faktin se malli i blerë në Kinë fillimisht kishte shkuar në Maqedoni pastaj një pjesë kishte dalë në tregun e Maqedonisë kurse pjesa tjetër në Kosovë dhe kështu kishte zhvilluar biznesin e tij për disa vite deri sa ishte kontaktuar nga ana e autoriteteve tatimore.

Kurse personi I.L, pronar i kompanisë N.T.P "R" është mbrojtur në heshtje.

Eksperti financiar ka përshkruar faktin se kompania "M", duke u bazuar në të dhënat tatimore dhe doganore del se ka importuar mallra nga Kina në vlerë prej 1.006.135,95€, kurse ka transferuar mallra nga Kina në vlerë prej 819.344,57€, kurse kompania N.T.P "R", ka importuar mallra me vlerë prej 733.226,71, kurse ka importuar mallra me vlerë prej 645.655,73€.

Detyra:

Bazuar në tekstin e mësipërm pjesëmarrësit duhet të definojnë se a ekzistojnë elemente të veprës penale të pastrimit të parave dhe nëse po, atëherë të identifikojnë dhe të përshkruajnë elementet e kësaj vepre penale:

Nëse evidontehet se ekzistojnë elementet e veprës penale të pastrimit të parave, atëherë të përshkruhet se për tu realizuar kjo vepër a është e domosdoshme që të ndërlihet me ndonjë vepër tjetër penale dhe nëse po, të përshkruhet shkurtimisht se në rastin konkret cila vepër penale do të ndërlihej me veprën bazë të pastrimit të parave:

Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave

Fenomeni i pastrimit të parave karakterizohet nga fakti se, në shumicën e rasteve, pastrimi i parave gjithnjë e më tepër është duke i prekur shumicën e vendeve të botës dhe njëherit duke i kaluar në shumicën e rasteve kufijt nacional dhe ata tej oqeanik. Për këtë arsye, shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit në mënyrë intensive dhe efikase do të ketë impakt pozitiv në luftën kundër këtyre fenomeneve negative.

Profili i rrezikut të Kosovës e bën sigurimin e bashkëpunimit ndërkombëtar një çështje me rëndësi të madhe. Kjo ndërlidhet jo vetëm me lidhjet rajonale dhe me pasurinë me origjinë kriminale në vendet fqinje, por edhe me komunitetin e madh të diasporës që ka Kosova në vendet e BE-së dhe të Zonës Ekonomike Evropiane.

Raporti i vlerësimit të vendit (PECK II) thekson që ndihma juridike ndërkombëtare lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive për periudhën 2014-2018 ishte mjaft e kufizuar. Është vërejtur se të gjitha kërkesat drejtuar autoriteteve të Kosovës janë ekzekutuar, mirëpo nuk ka përfundime të mëtjshme për efektivitetin apo shpjegimin e përdorimit të rrallë të NNJ-së për qëllime të tilla, duke pasur parasysh mungesën e informatave mbi rastet specifike. Kërkesat dalëse për NNJ-në në lidhje me PP-në janë vlerësuar se janë të ulëta. Këto statistika të kombinuara me numrin përgjithësisht të ulët të kërkesave mund të jenë tregues i përdorimit të pamjaftueshëm të potencialit të NNJ-sën ga autoritetet e Kosovës.

Ligji PPP/ LFT i jep mandat NJIF-K që spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione dhe i nënshtrohen obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të shpërlarjes së parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

NJIF-ja është në gjendje për të shkëmbyer ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të mundura direkt ose indirekt nga NjIF.

NjIF-i angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit në bazë të kompetencave të veta të gjera sipas Ligjit për PPP/LFT-në, Marrëveshjeve të Mirëkuptimit të arritura me një sërë vendesh dhe në respektim të rreptë të parimeve të Grupit Egmont si anëtare e kësaj organizate që nga viti 2017. NjIF-i nuk ka nevojë për Marrëveshje Mirëkuptimi si parakusht për shkëmbimin e informacionit, mirëpo ka arritur 16 Marrëveshje Mirëkuptimi, përfshirë rishikimet dhe ripërtëritjet e Marrëveshjevetë Mirëkuptimit me disa vende, duke shfaqur kështu përpjekje shtesë për t'u angazhuar në shkëmbim të informacionit me partnerët rajonalë më të rëndësishëm.

Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve të NjIF-it rregullohet edhe nga tre PSO të brendshme për përdorimin e sistemit goAML, shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit dhe funksionin e inteligjencës dhe analizës së NjIF-it.

Legjislacioni

Ofrimi i ndihmës juridike në çështjet penale mbështetet në një kornizë ligjore mjaft të gjerë në Kosovë. Baza ligjore për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike është Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (Ligji për NNJ-në) si dhe neni 62 i Ligjit për PPP/LFT-në.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar zbatohet në pajtim me nenin 1 të Ligjit për NNJ-në në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose parimit të reciprocitetit kur mungon një marrëveshje ndërkombëtare. Ligji lejon gamën më të gjerë të ndihmës që u referohet procedurave të KPP-së, si dhe sigurimin e procedurave të mëtejshme sipas neneve 89 dhe 98.

Kërkesat e NNJ-së duhet të kanalizohen përmes departamentit përkatës në Ministrinë e Drejtësisë (Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar) edhe pse ligji përcakton përdorimin e kanaleve diplomatike aty ku është e nevojshme. Në të njëjtën kohë, Ligji për PPP/LFT-në kërkon përdorimin e kanaleve diplomatike.

Llojet e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Letërporositë

Ndihma e ndërsjellë juridike

Traktati për ndihmë juridike reciproke (MLAT)

Marrëveshje për ndihmë juridike të ndërsjellë (MLAA)

Memorandumet e Mirëkuptimit(MM) dhe reciprociteti

Policia dhe autoritetet e inspektimit

Doganat dhe tatimet

Autoritetet mbikëqyrëse

Bankat Qendrore

Mbikqyrja e Bursës

Mbikqyrja e Sigurimit

Rrjeti i organizatave ndërkombëtare shumëpalëshe

Egmont Group

Njësitë e Inteligjencës Financiare

INTERPOL

ILECU

CARIN

Regjionale

etj

Letër Porositë - Metodatat e zakonshme të marrjes së ndihmës juridike nga jashtë në mungesë të një traktati ose marrëveshje ekzekutive.

Kërkesat nga gjykatat në një shtet tek gjyqësori i një shteti të huaj që kërkon kryerjen e një veprimi. Letërporositë mund të përdoren në vendet ku traktatet mbi ndihmën gjyqësore nuk janë në fuqi.

Kanalet shumë palëshe mund të përdoren njëkohësisht. Për të identifikuar provat apo gjurmuar pasuritë së pari mund të përdoren kanalet më të shpejta të sigurimit të informacionit të tilla si NJIF-ët, ILECU etj. Bazuar në rezultatet e përgjigjeve të kërkesave administrative për informacion, kanalet formale të tilla si MLAT janë përdorur më pas për të marrë dëshmi apo ndihmë tjetër.

Bashkëpunimi mes Njësiteve të Inteligjencës Financiare

Egmont Grupi është një organizëm i bashkuar i 166 Njësiteve të Inteligjencës Financiare (NJIF). Themeluar në vitin 1995. Ofron një forum për NJIF-të nga e gjithë bota për të *përmirësuar mbështetjen për qeveritë e tyre përkatëse në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve tjera financiare.*

Mbështetja e ofruar nga Egmont group për anëtarët e vet përfshinë:

Zgjerimin dhe sistematizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këmbimin reciprok të informacioneve të inteligjencës financiare,

Rritjen e efektivitetit të NJIF-ve duke ofruar trajnim dhe këmbim të personelit për të përmirësuar ekspertizën dhe aftësitë e personelit të punësuar nga NJIF-të,

Kultivimin e komunikimit më të mirë dhe të sigurt ndërmjet NJIF-ve përmes aplikimit të teknologjisë, aktualisht përmes Egmont Secure Web – Uebfaqja e sigurt e Egmont-it (ESW), dhe

Promovimin e themelimit të NJIF-ve në ato juridiksione pa pasur program nacional kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, apo në fushat me program në fazën fillestare të zhvillimit

Egmont Group ofron një platformë për shkëmbimin e sigurt të ekspertizës dhe inteligjencës financiare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (PP / FT). Kjo ka rëndësi të veçantë pasi NJIF-ët janë pozicionuar në mënyrë unike për të bashkëpunuar dhe mbështetur përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe janë porta e besuar për ndarjen e informacionit financiar brenda dhe jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare të luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (LPP / LFT).

Ndarja e të dhënave të inteligjencës financiare midis shteteve është e një rëndësie të madhe dhe është bërë themeli i përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar PP / FT. Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF) në të gjithë botën janë të detyruar nga standardet ndërkombëtare të shkëmbejnë informacion dhe të angazhohen në bashkëpunim ndërkombëtar. Si një forum ndërkombëtar i inteligjencës financiare, Egmont Group lehtëson dhe nxit bashkëpunimin midis NJIF-ve të saj anëtare.

Duhet të theksohet se bashkëpunimi midis NJIF-ve nuk është pjesë e procedurës penale dhe andaj konventat ndërkombëtare përkitazi me procedurën penale, nuk mund të përdoren.

Bashkëpunimi mes NJIF-ëve do të përfshijë informatat mbi përfitimet e dyshuara të krimit – pronë e cila mund të bëhet shënjestër për gjurmimin e aseteve dhe marje eventuale dhe konfiskim. Bashkëpunimi NJIF nuk kërkon dyshimin mbi krimin apo hetimin penal. Vendimet NJIF për ngrirjen e transakcioneve dhe asetet mund të jenë hapi i parë në procesin që çon drejt konfiskimit. "Dërgesat e kontrolluara" të aseteve janë të mundshme në bashkëpunimin mes NJIF-ëve, siç lejohen nga ligji nacional

Ekipet e Përbashkëta Hetimore

UNCAC 49

Vendimi Kornizë i Këshillit të BE i 13 qershorit 2002 mbi Ekipet e Përbashkëta Hetimore
Konventa e BE mbi Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore (NNL 2000)

Kur të konsiderohet Ekipi i Përbashkët?

Kur shteti(et) tjera kanë interes të përbashkët hetimor,

Kur në vijim e sipër apo ndonjë aktivitet tjetër penal serioz, i cili kërkon që hetimet të zhvillohen në territorin e më shumë se një shteti,

Nevoja për ti kushtuar resurse të mjaftueshme një hetimi në nivel vendi (i ndërlidhur me Procesin e Shënjestrimit) dhe jashtë – mundësisht duke përfshirë gjithashtu edhe Europol-in dhe Eurojust-in,
Kur të priten disa kërkesa për ndihmë ligjore,

Kur pritet nevoja për masa të fshehta dhe masa tjera detyruese dhe për koordinimin e tyre si dhe për mbledhjen dhe përdorimin e materialit (provave) të mbledhur në gjuhë të huaj

Kur pritet nevoja për intervistimin e të dyshuarve në një shtet të huaj mundësisht në gjuhën e tyre kombëtare,

Nevoja për të aplikuar përgjegjshmërinë penale në shtetin amë të të dyshuarit (p.sh të shkurtoj shpenzimet dhe parandaloj rrjetin kriminal)

Njësia Bashkërenduese Ndërkombëtare për Zbatimin e Ligjit (ILECU) është njësi brenda Policisë së Kosovës që ka përgjegjësi në ofrimin e një game të gjerë shkëmbimesh operative të informacionit, edhe në emër të DK-së dhe ATK-së në lidhje me aktivitetet e tyre hetimore. Dokumenti themelues i ILECU-t përcakton afatet kohore të sakta për ofrimin e informacionit nga homologët në Kosovë, përfshirë në raste shumë urgjente dhënien e menjëhershme të informacionit, brenda 24 orëve në raste urgjente dhe brenda tri (3) ditëve të punës në rastet prioritare. Afati kohor për rastet normale është brenda shtatë (7) ditëve të punës.

Dogana e Kosovës shkëmben informacion në pajtim me 12 marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunimin e ndërsjellë në çështje doganore me vende të tjera
Standardet ndërkombëtare të FATF – Bashkëpunimi ndërkombëtar

Instrumentet ndërkombëtare (Rekomandimi 36)

Ndihma e ndërsjellë juridike dhe Ekstradimi (R.37-39)

Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (R.40)

Fushat tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (R.8, R.24, R.25 & R.32)

Karakteristikat e një sistemi efektiv

Vendi siguron informacion ose ndihmë konstruktive dhe në kohë kur i kërkohet nga vendet e tjera.
Autoritetet kompetente ofrojnë ndihmë lidhur me kërkesat për:

zbulimin e vendndodhjes dhe ekstradimin e kriminelëve; dhe

identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin, konfiskimin dhe ndarjen e pasurive dhe ofrimin e informacionit (përfshirë provat, informacionin e fshehtë financiar, informatat mbikëqyrëse dhe ato për pronësinë përfituese) lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose veprat penale kryesore të ndërlidhura me to.

Po kështu, autoritetet kompetente kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar për ndjekjen e kriminelëve dhe pasurive të tyre. Me kalimin e kohës, kjo e bën vendin të mos jetë një vendndodhje tërheqëse për kriminelët (përfshirë terroristët) për të vepruar aty, për të mbajtur të ardhurat e tyre të paligjshme apo për ta përdorur si strehë të sigurt.

Autoritetet e ndjekjes penale duhet të bëjnë përpjekje për të përdorur ndihmën juridike për bashkëpunim ndërkombëtar në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë, për të ndjekur brenda vendit rastet e PP-së, veprave penale kryesore të ndërlidhura me të dhe financimit të terrorizmit që kanë elemente ndërkombëtare.

Autoritetet e tjera kompetente duhet të përdorin forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer informacion të fshehtë financiar, mbikëqyrës, në fushën e zbatimit të ligjit ose informata të tjera në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë me homologët e huaj për qëllime të PPP/LFT-së.

Autoritetet kompetente duhet të ofrojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të huaja për bashkëpunim në identifikimin dhe shkëmbimin e informacionit bazë dhe të pronësisë përfituese të personave juridike dhe marrëveshjeve juridike.

Gamë e gjerë e bashkëpunimit ndërkombëtar

Në përputhje me nenin 62 të Ligjit për PPP/LFT, autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e shpëlarjes së parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të shpëlarjes së parave dhe aktivitetit terrorist.

Procedurat për sigurimin e bashkëpunimit janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozitat e tjera të tilla përkatëse të ligjeve në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me të.

Shkëmbimi i shpejtë dhe konstruktiv i informacionit

Rekomandim 40.2 i FATF kërkon: porta, mekanizma apo kanale të qarta dhe efektive që do të lehtësojnë dhe të lejojnë shkëmbime të shpejta dhe konstruktive të informacionit të drejtpërdrejtë mes homologëve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar jashtë fushës së Ndhmës së ndërsjellt juridike (NNJ) në fushën e PP/LFT kryhet nga:

Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) dhe
Policia e Kosovës (PK).
Prokuroria e Shtetit

Memorandumet e Bashkëpunimit

Ndonëse NJIF ligjërisht mund të ndajë informacion spontanisht ose sipas kërkesës, NJIF ka hyrë në MM të ndryshme me vendet fqinje për krijimin e procedurave për shkëmbimin e informacionit.

NJIF-K-ja mund të nënshkruajë një kontratë ose marrëveshje me një agjenci homologe të huaj e cila kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e fshehtësisë.

Memorandumet e Mirëkuptimit me FIU ndërkombëtare			
Juridiksioni	Viti	Juridiksioni	Viti
Shqipëri (DPPPP)	2009	Polonia (GIIF)	2014
Maqedoni (MLPD)	2009	Shqipëri (DPPPP)*	2014

Mali I Zi (APML)	2009	Hungari (HFIU)	2015
San Marino (FIA)	2009	Maqedoni (FIO)*	2015
Sllovenia (OMLP)	2009	Ghana (FIC)	2015
Kroaci (AMLO)	2010	Lithuania (FCIS)	2016
Turqia (MASAK)	2012	FIU Jordani	2018
Republika Çeke (FAU-CR)	2012	FIU Senegal	2018
Finlanda (FIU)	2013	Mali I Zi (APML) *	2019
		FIU Taiwan	2020

Shkëmbimi i informacionit spontan/sipas kërkesës

Standardet nderkombetare te FATF kërkojnë që shkëmbimi i informacionit duhet të jetë i mundur edhe në mënyrë spontane edhe me kërkesë dhe në lidhje me të dyja: PP dhe të veprës penale kryesore themelore

Paragrafi (4) i nenit 15 të Ligjit për LPP/LFT i lejon NJIF-it që, spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionin me agjencinë homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që u nënshtrohet detyrimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht prej natyrës së agjencisë, gjë që i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e NJIF-it dhe vetëm për qëllime të luftimit të PP, të veprave të ndërlidhura penale dhe të FT.

Përveç kësaj, Ligji për LPP/LFT i jep kompetenca NJIF-it të shkëmbejë, në nivel vendor dhe ndërkombëtar, tërë informacionin që mund të qaset ose të merret drejtpërdrejt apo tërthorazi nga ai

Kryerja e analizave në emër të homologëve të huaj

Autoritetet kompetente duhet të jenë të autorizuar për të bërë pyetje në emër të homologëve të huaj. Për më tepër

- NJIF duhet veçanërisht të jetë i autorizuar për të kërkuar bazat e të dhënave të veta, duke përfshirë informacion në lidhje me RTD-të, dhe për të kërkuar bazat e të dhënave të tjera për të cilat NJIF ka qasje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji për LPP/LFT (AML/CFT)

NjIF është në gjendje që të kryejë analiza në emër të homologëve të huaj për informatat që janë në dispozicion publik dhe bazat e veta të dhënave (informacioni i ndërlidhur me RTD).

NjIF gëzon të drejtën për të kërkuar dhe për të pranuar nga organet publike a qeveritare apo organet ose organizatat ndërkombëtare a organizatat ndërqeveritare (në Kosovë):

- të dhëna,
 - informacione,
 - dokumente në lidhje me personin, subjektin, pasurinë apo transaksionin dhe
- mund që spontanisht ose me anë të kërkesës ndajë informacionin me agjencinë homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet detyrimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht prej natyrës së agjencisë që i nënshtrohet reciprocitetit.

Siguria e Informacionit

Përveç përdorimit për qëllime specifike, kërkohet autorizimi paraprak për shpërndarjen e mëtejshme. Përdorimi i mënyrës së sigurt, dhe përmes kanaleve ose mekanizmave të besueshëm për shkëmbim. Mundësia për të refuzuar kërkesën nëse autoriteti kërkues nuk mund të mbrojë konfidencialitetin e informacionit të shkëmbyer.

Kushtet jo-proporcionale dhe padrejtësisht të kufizueshme

Shkëmbimi i informacionit nuk duhet t'i nënshtrohet kushteve të tepruara ose padrejtësisht kufizuese.

Ligji për LPP/LFT (AML/CFT) - Me rastin e dhënies së kompetencave NJIF për të shkëmbyer informacion spontanisht ose sipas kërkesës Ligji për LPP/LFT nuk imponon kushte jo-proporcionale ose padrejtësisht kufizuese.

Në përputhje me praktikën e përgjithshme ndërkombëtare në shkëmbimin e informacionit të tillë, paragrafi (4) I nenit 15 kërkon që shkëmbimi i informacionit t'i nënshtrohet reciprocitetit dhe se informacioni i dhënë do të përdoret vetëm me pëlqimin e NJIF dhe vetëm për qëllime të luftës kundër PP, veprave penale kryesore dhe FT.

- Kushte e tilla nuk duhet të kritikohen pasi që objektivi i tyre është mbrojtja dhe përdorimi i informacionit të shkëmbyer

Refuzimi në bazë të ligjeve të konfidencialitetit

Sekreti Profesional - bashkëpunim nuk duhet të refuzohen për shkak të ligjeve që imponojnë kërkesa të sekretit apo konfidencialitetit, nga institucionet financiare dhe BPCJF-ve përveç kur zbatohet privilegji ligjor profesional apo sekreti ligjor profesional Ligji për LPP/LFT (AML/CFT).

Në rast të kërkesave të referuara te NJIF, paragrafi (1) i nenit 63 i Ligjit LPP përcakton se: sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informacionit që duhet të përcaktohet me ligji ose është mbledhur në përputhje me Ligjin për LPP/LFT.

Ekzistojnë përjashtime përkitazi me privilegjin ligjor profesional në dhënien e këshillave ligjore dhe në lidhje me ofrimin e informacionit për qëllime të kujdesit

Përdorimi i informacionit të shkëmbyer

Rekomandimi i FATF 40.9 - vendet duhet të parashohin kontrole dhe mbrojtje për të siguruar që informacioni i pranuar nga autoritetet kompetente përdoret vetëm në mënyrë të autorizuar, në pajtim me dispozitat vendore mbi privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Ligjit Nr. 05/L-096

Duhet të respektohen kërkesat e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kërkesat për informacionin që do të lëshohet duhet të respektojnë standardet minimale të mbrojtjes të të dhënave.

Pala që parashtron kërkesën duhet të paraqes

- arsyet për kërkesën,
- veprën e dyshuar penale dhe një përvijim të rrethanave,
- se si do të përdoret informacioni i kërkuar dhe
- se si do të ruhet nëse i jepet palës që ka parashtrua kërkesën për atë informacion.

Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, nenet 3 dhe 14

Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit

Bashkëpunimi me jo homologët - Mekanizmat për të lejuar shkëmbimin e duhur dhe konstruktiv të informacionit me jo homologë.

Arsyeja e kërkesës - autoriteti kërkuar i shpallorë autoritetit kërkuar arsyen e kërkesës dhe në emër të kujt bëhet kërkesa.

INTERPOL & ILECU - Shkëmbimi i informatave me palët e tjera bëhet përmes kanaleve të tërthorta.

- Në çdo rast, pozita e zyrës së ILECU-t (DBNZL) ose e INTERPOL-it do të thotë se ekziston një ndërmjetës në këtë proces.

Gjatë shkëmbimit, autoriteti që parashtron kërkesën duhet të zbulojë qëllimin e kërkesës, atë se për çka do të përdoret informacioni dhe duhet të paraqesë informata të tjera për t'i mundësuar palës që përpunon kërkesën që të kërkojë informata të mjaftueshme për të vërtetuar nëse kërkesa është në përputhje me ligjin.

STKE 198 - Konventa e Këshillit të Evropës

Neni 46 i Konventës merret me bashkëpunimin midis NJIF dhe, për këtë qëllim, ajo përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga NJIF në mënyrë që të sigurojë bashkëpunim sa më të gjerë të mundur..

Bashkëpunimi i NJIF me të gjitha llojet e NJIF - STKE 198 neni 46.3

Paragrafi (3) i nenit 46 të STKE 198 i bën thirrje çdo Pale të Konventës për të siguruar se performancat e funksioneve të NJIF-ëve të tyre përkatëse sipas nenit 46 nuk janë të prekura nga statusi i tyre i brendshëm, pavarësisht se ato janë administrative, autoritete të zbatimit të ligjit ose gjyqësore.

Ofrimi i informacionit nga NJIF - Paragrafi (5) i nenit 46 i STKE 198 kërkon që në bazë të kërkesës së bërë në pajtim me nenin 46, NJIF duhet të ofrojë tërë informacionin relevant, përfshirë informacionin financiar të qasur dhe të dhënat e kerkuara të zbatimit të ligjit, të dhëna në kërkesë, pa nevojë për një letër kërkesë formale sipas konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare sipas Palëve

Kufizimet për përdorimin e informacionit nga palët e treta- STKE 198, neni 46.7

Në lidhje me paragrafin (7) të nenit 46 STKE 198, informacionet ose dokumentet e marra sipas nenit 46 përdoren vetëm për qëllime të luftimit të PP dhe hetimeve brenda NJIF. Kështu, informacioni i ofruar nga NJIF homolog nuk duhet t'i shpërndahet palëve të treta, e as të përdoret nga NJIF-i pranues për qëllime të tjera nga analiza, pa pëlqimin paraprak të NJIF-it mbikëqyrës

Caktimi i kufizimeve dhe kushteve për përdorimin e informacionit- STKE 198, neni 46.8)

Paragrafi (8) i nenit 46 i Konventës i jep kompetenca NJIF-it që dërgon informacionin që me rastin e dërgimit të informacionit ose dokumenteve të imponojë kufizime dhe kushte mbi përdorimin e informacionit për qëllime të tjera nga ato të përmendura në nenin 46, dhe NJIF-i pranues duhet t'i përmbush ashtu si duhet.

Refuzimi i përdorimit të informacionit si provë në hetime - STKE 198, neni 46.9

Sipas paragrafit (9) të nenit 46 të STKE 198, NJIF-i transmetues nuk mund ta refuzojë pëlqimin e vet për kërkesën e Palës tjetër për përdorimin e informacionit apo dokumenteve të transmetuara për hetime penale apo ndjekje penale përveç nëse këtë e bën mbi bazën e kufizimeve sipas legjislacionit vendor apo kushteve të parapara në nenin 46. Çfarëdo refuzimi për të dhënë pëlqimin duhet të sqarohet në mënyrë të duhur.

Informacioni i transmetuar nuk është i qasshëm për agjencitë e tjera - STKE 198, neni 46.11

Paragrafi (10) i nenit 46 të STKE 198 detyron NJIF për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë edhe masat e sigurisë, për të siguruar që informacioni i paraqitur në zbatim të nenit 46 nuk i jepet asnjë autoriteti, agjencie apo departamenteve. Për këtë qëllim, paragrafi (11) kërkon që informacioni i paraqitur do të mbrohet me të paktën të njëjtat rregulla të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si ato që zbatohen në bazë të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm për NJIF-in kërkuar

Bashkëpunimi Rajonal

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që vendet duhet të zbatojnë një sistem deklarimi ose sistem të paraqitjes së informacionit për transportimin ndërkufitar në hyrje dhe dalje të parave të gatshme dhe instrumenteve të negociueshme të mbajtësit (INM). Vendet duhet të sigurojnë që të kërkohej një deklaratë ose paraqitje e informacionit për të gjitha transportimet fizike ndërkufitare, qoftë nga udhëtarët apo me anë të postës dhe transportit të mallrave, por mund të shfrytëzojnë sisteme të ndryshme për mënyra të ndryshme të transportit.

Gjatë deklarimit, personat që japin deklarata ose paraqitje të rreme të informatave duhet t'u nënshtrohen sanksioneve proporcionale dhe dekurajuese, qofshin ato penale, civile ose administrative. Në nivel kombëtar, duhet siguar se ka bashkërendim të mjaftueshëm ndërmjet shërbimeve të doganës, atyre të imigracionit dhe autoriteteve të tjera përkatëse.

Kosova duhet të sigurojë që sistemi i deklarimit/paraqitjes lejon bashkëpunimin dhe ndihmën ndërkombëtare. Për të lehtësuar këtë bashkëpunim, informacioni duhet të ruhet në rastet kur:

(a) bëhet një deklaratë ose paraqitje e informatave që tejkalon pragun e përcaktuar; ose

(b) ka një deklaratë të rreme ose paraqitje të informatave të rreme; ose

(c) ka dyshime për PP/FT.

Personat që kryejnë transportim fizik ndërkufitar të parave të gatshme të cilat kanë lidhje me PP/FT-në ose vepra penale kryesore duhet t'u nënshtrohen:

(a) sanksioneve proporcionale dhe dekurajuese, qofshin ato penale, civile ose administrative; dhe

(b) masave, të cilat lejojnë konfiskimin e këtyre parave të gatshme

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR - Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

Autoritetet e Kosovës kanë krijuar një sistem gjithëpërfshirës dhe bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të ofruar një gamë të gjerë të NNJ-së, mirëpo disa çështje që kanë të bëjnë me kërkesat legislative dhe procedurat e ndërlikuara të bashkëpunimit ndërkombëtar të NNJ-së kanë ndikim në afatin e ndihmës. Autoritetet kanë marrë masa përmirësuese, por nevojiten masa të mëtejshme për të adresuar çështjet e mbetura.

Sistemet dhe procedurat për përcaktimin e prioriteteve të kërkesave të NNJ-së që ka pranuar Kosova nuk janë zbatuar nga të gjitha autoritetet.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë demonstruar përdorim aktiv të NNJ-së për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale të PP-së dhe FT-së në Kosovë.

NjIF-i shkëmben aktivisht informata për PP-në, veprat e ndërlidhura dhe FT-në, që përdoren në analizat e veta dhe për të mbështetur përpjekjet e AZL-ve. Vlerësuesit nuk kanë ndonjë tregues për ndonjë çështje që ka të bëjë me afatin e ofrimit të informacionit.

Pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të AZL-ve për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar, nuk u demonstrua mjaftueshëm se ato përqendrohen si duhet në rastet e PP-së dhe FT-së. Bashkëpunimi mbikëqyrës në këtë drejtim duket të jetë i kufizuar.

Mangësitë e përgjithshme lidhur me qasjen në informacionin për pronësinë përfituese ndikojnë edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Veprimet e rekomanduara

Autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa të mëtejshme legislative dhe të zbatojnë mekanizma shtesë të bashkëpunimit ndër institucional për të siguruar afatin e përgjigjeve ndaj kërkesave për NNJ-në.

Autoritetet duhet të përqendrohen më tej në përdorimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, të sigurojnë se ka bazë formale të përshtatshme për këtë bashkëpunim dhe të zbatojnë masa për të monitoruar dhe shmangur si duhet teprinë në këtë bashkëpunim, kudo që ligjërisht është e mundur.

Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë priorizimin sistematik të rasteve të NNJ-së nga të gjitha institucionet kompetente bazuar në procedurat e brendshme të avancuara dhe sistemet e menaxhimit të rasteve.

Autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin masa urgjente për të vlerësuar arsyet e rënies së përdorimit të kanalit të bashkëpunimit të NNJ-së për ndjekjen e rasteve të PP-së dhe për të siguruar që në të gjitha rastet e mundshme të PP-së ndihma juridike ndërkombëtare të shfrytëzohet si duhet bazuar vetëm mbi prioritetet hetimore dhe pavarësisht pengesave procedurale që mund të jenë të ndërlidhura me praktikën e krijuar (si është theksuar nën RM 7).

NjIF-i duhet të zhvillojë më tej aftësinë për qasje në afat dhe përdorim të të gjitha informatave, sidomos të informacionit ku ka qasje të tërthortë nga burime të jashtme, për qëllime të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit.

AZL-të Kosovës duhet të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar në mënyrë proaktive për të siguruar se të gjitha rastet e mundshme tëPP-së dhe FT-së eksplorohehen si duhet.

Duhet të organizohet rregullisht trajnim i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm për të gjitha autoritetet hetuese të Kosovës se si të kërkojnë dhe të përdorin ndihmën juridike ndërkombëtare.

Përforcimi i përdorimit të inteligjencës financiare si dhe i të dhënave të tjera të ngjashme

Në dhjetor 2018 është miratuar Raporti i Vlerësimit për vlerësimin e përputhshmërisë së Kosovës me Standardet ndërkombëtare në fushën e Pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit sipas metodologjisë së FATF, proces ky i kryer nën mbështetjen e projektit PECK II të Këshillit të Evropës, duke angazhuar eksperte të kualifikuar ndërkombëtar.

Dy nga rezultatet e menjërerëshme të FATF (6 dhe 7) lidhen shumë ngushtë me njëra tjetër, pasi Rezultati i menjëhershëm 6 në thelb kërkon përdorim të informacionit financiar të shumëllojshëm për hetimin e PP/FT, duke mos u mjaftuar vetëm me kryejën e analizave cilësorë nga njësitë e inteligjencës financiare apo agjencitë e zbatimit të ligjit (AZL), burimin e larmishëm dhe cilësor të informacionit të marre, por duke synuar që ky informacion financiar të përdoret për hetimet e zhvilluara për të identifikuar dhe gjurmuar skemat e pastrimit të parave dhe pasuritë përkatëse; përderisa Rezultati i menjëhershëm 7 synon vijimin e masave të kërkuara sa më sipër pra hetimi → ndjekja penale → dënimi → ndëshkimin e tyre me masa ndëshkimore efektive, proporcionale dhe dekurajuese për kriminelët.

Bazuar në analizën e kryer nga ekspertët në kuadër të Raporti i Vlerësimit për përputhshmërinë së Kosovës me Standardet e FATF është konstatuar se nuk është ka asnjë mangësi madhore që pengojë hetimin efektiv të pastrimit të parave të çdo forme, aplikimin e metodave të përshtatshme të hetimit, vendosjen e masave për bllokim apo sekuestrim pasurie, me synim final konfiskimin e saj. Kjo është e provuar nga vlerësimi i rekomandimeve teknike 3 (Vepra penale e pastrimit të parave), 29 (Njësitë e Inteligjencës Financiare - NJIF), 30 (Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit), 31 (Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të hetimit) dhe 32 (Korrierët e parave të gatshme) për të cilat vlerësimi është gjerësisht si të përmbushura.

Nuk ka asnjë standard që kërkon çështje penale të hapur në çdo rast të dërguara nga NJIF, mirëpo Policia si institucioni që pranon numrin më të madh të informacioneve nga NJIF dhe autoritetet tjera, duhet krijojë një mekanizëm për dërgimin e informatave kthyesë për çdo rast, me marrje vendimi përkatëse dhe reagim për NJIF, duke evidentuar në qoftëse ka ndonjë kërkesë shtesë apo mangësi nëse konstatohen të tilla. Nuk është e përshtatshme që nga një NJIF administrativ, Policia e Kosovës si ALZ (agjenci e zbatimit të ligjit) më e madhe në vend, apo PSRK, të kërkojë veprën penale bazë pasi thjesht kjo nuk është detyra e NJIF.

Është e natyrshme që sfida për Agjensionet e Zbatimit të Ligjit (AZL) është mbledhja e provave që lidhin pasurinë me aktivitetet kriminale dhe për këtë hetimi duhet të identifikojnë dhe gjurmojnë pasuritë deri në pikën kur lidhja me veprën penale ose vendndodhja e pasurive mund të përcaktohet. AZL gjatë hetimeve financiare, natyrisht që duhet të kombinojnë teknikat e mbledhjes së provave dhe hetimeve së bashku me teknikat e kontabilitetit dhe auditimit. Provat/faktet në një hetim financiar mund të vinë nga shumë drejtime dhe jo gjithmonë NJIF-ët kanë arritur të sigurojnë informacione të tilla. Andaj hetuesit duhet t'i shtojnë vlerë shtesë raporteve të inteligjencës së NJIF.

Është thelbësorë të kuptohet roli i NJIF si njësi inteligjence financiare dhe pritshmëria e AZL apo PSRK karshi NJIF të jenë në përputhje me detyrat që ka njësia.

Përtej shpërndarjes së rasteve të dyshimta (për PP/FT apo edhe aktivitet kriminal të pa përcaktuar në rastet kur përmbushen disa kritere), NJIF mund të angazhohet edhe në hetimet e nisura nga vetë AZL, në mënyrë që të ketë rol plotësues në këtë proces. AZL nëse e çmojnë, mund të zgjedhin që të përdorin aftësitë analitike dhe eksperiencën e NJIF në mënyrë që të zhvillojnë më tej rastet e tyre, mirëpo për ta arritur këtë duhet të informojnë NJIF:

për detajet e hetimit që po kryhet,
tipologjinë,

kohëzgjatjen e hetimit etj.,

pasi në të kundërt përgjigja që NJIF duhet të japë janë vetëm të dhënat në bazën e të dhënave të saj, pa asnjë interpretim pasi ky nuk është kërkuar dhe as i mundur.

Edhe për një pjesë të rasteve të shpërndara me iniciativë të NJIF për AZL, PSRK apo prokuroritë themelore dhe autoritetet tjera kompetente, ka pritshmëri që pas hetimit të mëtejshëm, mund të lidhet me një subjekt më interes ekzistues për ato institucione apo të nxisë hetime të mëtejshme proaktive për të kuptuar dhe sqaruar më tej rastin.

Duke marrë në konsideratë se Raportet e Transaksioneve të Dyshimta (RTD) nuk duhet të konsiderohen si kallëzim penal apo “Raporte të veprimtarisë kriminale”, një pjesë e konsiderueshme e tyre shpjegon aktivitete kriminale në fushën e evazionit fiskal, mashtrimeve, falsifikimeve, kryerjen e transaksioneve me qëllim shmangien e raportimeve etj, raste këto që duhen trajtuar dhe me tej informuar NJIF për rezultatet.

Vlera e RTD-ve dhe analizës së NJIF (bazuar në të dhënat që ka në bazën e të dhënave apo atyre që mbledh nga subjektet raportuese apo autoritetet publike) rritet kur krahasohet dhe ndërlidhet me të dhënat që kanë apo mund të sigurojnë autoritetet e zbatimit të ligjit apo edhe ato të PSRK. Është e rëndësishme që palët të kuptojnë secila detyrat e veta, sa është trajtimi i rasteve nga secila si dhe ku bashkohet mozaiku i hetimit në tërësinë e vet nga ku do të dalin aspektet e tjera që ngelen për tu zbuluar apo plotësuar pastaj.

NJIF-ët duke mos qenë agjensionet të ndjekjes penale, natyrisht nuk ka kompetenca për mbledhjen e provave në teren apo masave të mshefta të hetimit dhe mund të mos zbulojë lidhjet kriminale në qoftëse këto nuk evidentohen paraprakisht në të dhënat që ka në dispozicion. Më tej NJIF duhet të dërgojë në AZL edhe për rastet që nuk ka të dhëna për aktivitet kriminal për personat që po kryejnë transaksione të caktuara, por të cilat nuk kanë logjikë të ligjshme ekonomike, kryhen me mangësi në të dhëna apo përshkrim, nuk ka të dhëna për burimin e fonde, përputhen me tipologji të njohura apo kryhen në formën e strukturimit. Në këto raste, në parim ka 3 kategori dyshimesh për krime bazë: shkelje apo krime në fushën tatimore/doganore, korrupsion apo krim të organizuar dhe rastet mund të jenë vetëpastrim, pastrim nga të tretë apo e përzier.

Duke marrë në konsideratë se në thelb ka dy qasje për hetimin e PP, e para nga krimi bazë, për të arritur te pasuria dhe e dyta është nga pasuria të gjurmohet krimi. Kjo e dyta është sfida më e madhe, ajo më reale dhe prioritet, ajo edhe për të cilën në thelb është krijuar sistemi parandalues, detyrimet për raportim, NJIF etj.

Hetimi dhe ndjekja penale

Si të përmirësojmë identifikimin e rasteve dhe hetimin e pastrimit të parave, rregullsinë dhe vazhdimësinë e hetimeve dhe ndjekjes penale, në përputhje me kërcënimet, profilin e rrezikut dhe politikat e Kosovës?

Vendosja e një sistemi prioritizimit të rasteve të pastrimit të parave;

Krimineli nuk është i çmendur sa të thotë se kjo fakturë fiskale është e ardhur nga krimi, megjithëse edhe mund të mbaj kontabilitet për veten e tij, këtë nuk do ja dorëzojë autoriteteve të zbatimit të ligjit; Nisur nga gjetjet e raportit të PEK II, vlerësohet se ka nevojë për specializim të mëtijshëm të prokurorëve të PSRK por sidomos edhe të gjyqtarëve që do të trajtojnë çështjet e Pastrimit të Parave; Hetimi financiar duhet të kërkohet nga ana e prokurorë që të jetë sa më i plotë i mundshëm me detaje të sakta për pasuritë e ligjshme dhe ato të paligjshme, të dhënat kriminale etj.

Në vëmendje që për rastet kur hetimi financiar rezulton i komplikuar, hetimi i PPMund të ndahet nga vepra bazë. Duhet të kemi në konsideratë se ka raste p.sh. si denoncimet për korrupsion të zyrtarëve kur shkeljet e tyre nuk mund të provohen, janë të vazhdueshme dhe të shtrira në kohë.

Në këto raste përdorimi i hetimit financiar, gjatë hetimit të gjerë kriminal, mund të çojë në gjetje të transaksioneve që nuk mund të shpjegohen qartë, familjarëve apo personave të tretë të lidhur me ta, prova këto që mbështesin një akuzë për PP.

Duke e ngarkuar akuzën me PP rritet mundësia e dënimit edhe për krimet e tjera shoqëruese.

Megjithëse tri fazat e Pastrimit të parave shpjegohen shpesh në trajnime, legjislacioni nuk kërkon domosdo përmbylljen e tri fazave për të dënuar shkelësit, procesi i Pastrimit të Parave mund të jetë krim vazhdues si dhe ka persona që vazhdimisht përfitojnë të ardhura kriminale dhe e transformojnë Pastrimin e Parave në proces pastrimi që nuk ka ndalim.

Përvoja në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar tregon se nëse bëhet një thjeshtim i procesit të pastrimi i parave, në mënyrë empirike mund të thuhet se kalon kryesisht në 3 fazat klasike Vendosja → Shtresëzimi → Integrimi, mirëpo në realitet, për profesionistët e fushës, shpesh herë dallimi mes fazave të mësipërme është i vështirë sepse një organizatë kriminale (apo individ) që merret me aktivitet të paligjshëm mund të përdorë njërën prej tyre apo ndërthurje të tyre njëkohësisht, në mënyrë graduale apo të vazhdueshme.

Nga ana tjetër duhet të kemi gjithnjë në konsideratë se përshkrimi i PP në legjislacion në Kosovë nuk e kërkon këtë ndarje në faza, përkundrazi mund të konsumohet si vepër penale edhe vetëm duke kryer fshehjen e produktit kriminal. Pra është shumë e rëndësishme që AZL, PSRK, Gjykatës etj., mos të kenë pritshmëri që në një rast të hetuar/gjykuar të ketë një ndarje në faza, pasi ligji nuk e kërkon një gjë të tillë, nuk ka pse të jetë e tillë as logjikisht dhe në realitet është e vështirë që të ketë një ndarje kaq të qartë.

Është shumë e rëndësishme që të përdoren mekanizmat ekzistues ligjore, mos të ketë ndryshime të shpeshta si dhe mos të kërkohet ligji i përsosur që mund t'i parashikoj të gjitha situatat, pasi e gjitha kjo do të ishte betejë e humbur që në fillim;

Kosova nuk ka asnjë pengesë ligjore apo organizative që pamundëson arritjen e rezultateve konkrete.

Pastrimi i parave si vepër penale autonome dhe përdorimi i provave rrethore

Pastrimi i parave nuk është shtesë e një veprë penale tjetër, por një vepër e rrezikshme për shtetin që godet ekonominë, barazinë në treg, konkurrencën e ndershme tregtare si dhe ul dukshëm besimin e qytetarëve ndaj shtetit sidomos në vende të vogla si Kosova.

Parimi i konfiskimit të produktit të veprës penale, apo apo të shumëfishuar ka ekzistuar para se të parashikohet vepra e Pastrimit të Parave (PP), mirëpo botërisht është pranuar se kjo qasje nuk mjafton dhe për këtë arsye është parashikuar vepra e PP si vepër penale autonome, që lejon dënim edhe pa pasur dënim për vepër penale bazë të formës së prere por kërkon përdorim të zgjeruar të provave rrethore, kundër provave, zbatimin e masave edhe përtej atyre penale (siç është në Kosovë psh) në kombimin me ato penale, lidhja me një aktivitet kriminal nuk është e domosdoshme të jetë episod për episod psh. të ardhura për çdo episod pasi kjo është e pamundur për dy arsye:

- a) krimi nuk lëshon faturë edhe në qoftëse krimineli mban kontabilitetin e tij, këtë nuk do ta vendosë në dispozicion të agjensioneve të ndjekjes penale dhe
- b) asnjë shtetet nuk pretendon se ka një parandalim aq të lartë saqë kur evidenton një aktivitet kriminal (korrupsion, trafik narkotikësh etj.) të besojë se është hera e parë dhe e vetme që është kryer, e për rrjedhojë në thelb ndërhyrja e AZL nuk lejon “pastrimin e parave” pasi kishte edhe efektin parandalues të këtij procesi.

Parimi i autonomisë së veprës penale të pastrimit të parave është i sanksionuar qartë në Konventën e Varshavës (CETS No.198)., e cila ndër të tjera, në neni 9 (Veprat penale të pastrimit të parave) pikat 5 dhe 6 të saj parashikon se

“5. Çdo Palë do të sigurojë që një dënim i mëparshëm ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk është parakusht për një dënim për pastrim parash.”

6. Çdo Palë do të garantojë që një dënim për pastrim parash në bazë të këtij neni është i mundshëm, nëse vërtetohet që një pasuri, objekt i paragrafit 1.a ose b i këtij neni, e ka origjinën nga një vepër penale kryesore, pa qenë e nevojshme të caktohet saktësisht se cila vepër penale.”

Krimi i pastrimit të parave mund të vërtetohet edhe duke u bazuar mbi prova rrethore, pikërisht këtë sanksionon edhe kjo Konventë në neni 9 pika 2 gërma “c” “pasja dijëni, qëllim ose motivim, të nevojshëm si elemente të veprës penale të parashtruar nga ai paragraf, mund të nxirren nga rrethana faktike objektive.”

Më tej, e njëjta Konventë në nenin 5 (Ngrirja, bllokimi dhe konfiskimi) të saj trajton qartë parimet për bllokim, sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë që rrjedh nga krimi, konkretisht:

“Çdo Palë merr ato masa legislative dhe të tjera të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, bllokimin dhe konfiskimin të përfshijnë edhe:

- a) pasurinë në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet;
- b) pasurinë e përfshirë nga burime të ligjshme, nëse fitimet janë përzier, pjesërisht ose tërësisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën që vlerësohen fitimet e përziera;
- c) të ardhurat ose privilegje të tjera që rrjedhin nga fitimet, nga pasuria në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet nga krimi ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet nga krimi, deri në vlerën e që vlerësohen fitimet e përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë sa edhe fitimet.”

Kosova nuk është palë e konventave të Këshillit të Evropës, mirëpo dukshëm legjislacioni vendas është hartuar në përputhje edhe standardet ndërkombëtare, përfshirë konventën e sipërcituar.

Është e pranuar në raport vlerësimit të PECK II por edhe në dokumente të tjera, që në Kosovë kryhen hetime paralele financiare, element ky për tu marrë si vërtet pozitiv. Ajo çfarë duhet të kemi në konsideratë është se hetimi paralel financiar mundet natyrisht që të konkludojë me ngritjen e një akuze të posaçme për PP ndaj personave të dyshuar dhe kjo është qasja e kërkuar. Natyrisht ka edhe raste kur këto lloj hetimesh nuk arrijnë të mbledhin të dhëna të mjaftueshme për një akuzë të posaçme penale për PP, mirëpo ndihmojnë prokurorin që të mbështesë më mirë akuzën për krimin bazë apo të origjinës, mund të shërbejnë për të aplikuar masa sigurie të pasurisë në rrezik tjetërsimi apo mund të shërbejnë në fazën e konfiskimit të produktit penal ekuivalent edhe pa pasur akuzë të posaçme për PP apo dënim për këtë vepër.

Pastrimi i Parave duhet të trajtohet jo me mendësinë e një krimi tradicional kur kërkohet lidhja shkakësorë e drejtpërdrejtë, por kërkon përdorimin e provave rrethore/indirekte, të lidhura dhe koherente mes tyre, përdorimin e kundër provave, për të dhënë një “pikturë” që përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të ardhurat janë ditur se janë nga krimi dhe janë investuar apo qoftë edhe vetëm depozituar apo fshehur, në çdo formë, nga vetë personat e përfshirë apo duke përdorur familjarë apo persona të afërt të tyre.

Duhet të pranohet se të provuarit e veprës penale bazë me vendim të formës së prerë nuk është as domosdoshmëri as kërkese ligjore. Pastrimi i Parave nuk duhet të konceptohet si aksesor shtesë, por si vepër penale autonome. Duhet të jemi të qartë se një qasje e tillë për Pastrim të Parave nuk është shkelje e të drejtave të njeriut as në vende të BE me sistem të lartë të garancisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë dëshmojnë edhe vendimet e gjykatave të të drejtave të njeriut.

Është thelbësorë që gjatë hetimit financiar (qoftë atij që vjen si rrjedhojë e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta apo informatave të NJIF apo atij të gjeneruar nga vetë Policia) mos të ketë fokusim të pakalueshëm të gjetja e veprës penale bazë gjeneruese rast për rast me vendim dënimi të formës së prerë pasi kjo në shumë raste është e pamundur, mirëpo duhet të kërkohen të dhëna për aktivitet kriminal. Në vëmendje që në fakt më shumë sesa gjetja e lidhjes me veprën penale/aktivitetin kriminal, në hetim financiar ka rëndësi identifikimi i personave që marrin pjesë në proces dhe rolin e gjithësecilit:

pjesë e sipërmarrjes kriminale,
vlerësimi i mënyrës së jetesës dhe standardit të saj (edhe de facto),
kryeja e transaksioneve në dukje të pa nevojshme apo që zgjasin disa procese që në kushte të tjera mund të kryhen në mënyrë më të thjeshtë,
shpërthimi i papritur ekonomik i bizneseve me të cilat personat lidhen,
përdorimi i pashpjegueshëm i parasë së gatshme,
hartimi i kontratave në duke formale apo fiktive për të legjitimuar një pjesë të transaksioneve etj.,
element këta që mund të kthehen në prova indirekte/rrethore për tu pranuar në koncept se pari nga

Prokurorët dhe më tej edhe nga Gjykatësit se shpjegimi i vetëm se pasuria është nga aktiviteti i paligjshëm. Të gjitha këto të dhëna janë shumë të vlefshme edhe në kuadër të zbatimit të masave të ligjit të ri për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit të Pasurisë.

Disa rastet për Pastrim të Parave mund të jenë të komplikuar që kërkojnë kohë dhe ekspertizë të caktuar, mirëpo ka edhe raste të thjeshta të cilat për shkak të thjeshtësisë së tyre nuk duhet të na keq orientojnë se nuk kemi të bëjmë me Pastrim të Parave. Rastet në duke të thjeshta janë të dy kategorive:

e para është inteligjenca e ulët e kategorive të caktuara të kriminelëve dhe;
e dyta është kategoria e krimit që mendon se është mjaftueshëm i fortë dhe me lidhje aq sa të shpërfillë nevojën për të kryer manovra për të bërë Pastrim të Parave, por e realizon procesin pa frikë dhe haptazi. Kjo kategori e dytë është shumë e rrezikshme në vende të vogla siç është Kosova.

Burimet dhe literatura

Ligji 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
Trajnimi ndërkombëtar për Teknikat e Hetimeve Financiare ZAT (Rich Prill 2008)
Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
Raporti i Vlerësimit të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimine financimit të terrorizmit.
Rekomandimet e FATF - standardet ndërkombëtare mbi pastrimin e parave luftimin dhe financimin e terrorizmit
Raportet dhe rekomandimet e ekspertit të OSBE